



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 20, datë 25 / 06 /2025

“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 % NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Maj 2025”

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.24.01.2025 “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor”, si dhe referuar relacionit permbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqeti Këshillit Bashkiak dhe:

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin Maj 2025, sipas listës bashkëlidhur, Nr. Familjeve **10**, **fondi 53.142 lekë.**
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë, për muajin Maj 2025, sipas listës bashkëlidhur, Nr.familjeve **90**, **fondi 327.853 lekë.**
2. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë, llogaria “Transfertë në buxhetet familjare”.
3. Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015,



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miraturar me vota	<u>24</u>
Vota Pro	<u>24</u>
Vota Kunder	<u>-</u>
Vota Abstenim	<u>-</u>
Zbardhur me datë	<u>26/06/2025</u>

KRYETAR
RUDIN HESLI

